



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI

Nr. 324/5 Prot.

Tiranë, më 27.02.2018

**VENDIM**  
Nr. 11 datë 27.02 2018

**MBI**

**MIRATIMIN E DISA PERCAKTIMEVE RREGULLUESE TË PRANIMIT TË  
STUDENTËVE ME KOHË TË PLOTË QË APLIKOJNË PËR TRANSFERIM  
STUDIMESH DHE PËR NJË PROGRAM TË DYTË STUDIMI NË TË NJËJTIN CIKËL  
STUDIMI NË CIKLIN E PARË DHE NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE**

Mbështetur në nenin 23,74,76, 85, 89 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Rektoratit nr. 29, dt. 20.02.2018, Senati Akademik i UST në mbledhjen e dt. 27.02.2018

**VENDOSI**

- A) Kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë të studimeve me transferim studimesh apo dhe për një program të dytë studimi janë të përcaktuara në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 2, dt. 9. 01. 2018. "Mbi miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve me kohë të plotë ne programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë për vitin akademik 2018-2019".
- B) Në rastin e transferimit të studimeve dhe të ndjekies së një programi të dytë studimi në të njëjtin cikël studimi do të zbatohen dhe përcaktimet rregulluese si më poshtë:
- C) **Për transferim të studimeve në ciklin e parë të studimeve.**
1. Transferimi bëhet në fillim të vitit akademik, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm i të njëjtit cikël dhe lloj, që studentët në programin e studimit nga vijnë i janë nështruar testimit praktik nëpërmjet konkurimit me teste praktike të njejta ose të perfërta me ato që organizon fakulteti ku kërkohet transferimi.
  2. Fakultetet, në rastin e miratimit të transferimit të studimeve, bëjnë njohje të krediteve dhe mund të përcaktojnë shlyerje të krediteve të caktuara bazuar në nenin 89, Ligji 80/2015, aktet nënligjore e aktet e brendëshme.

3. Bazuar në njohjen e krediteve të fituara nga studenti në IAL nga vjen dhe mbështetur në njësimin me Planin Mësimor të programit të studimit të UST në të cilin studenti kërkon të transferojë studimet, nëse për studentin përcaktohen më shumë se 30 kredite për shlyerje, atëhere ai nuk mund të regjistrohet në një kurs më të lartë se ai që ka përfunduar, por vazhdon studimet në të njëjtin kurs duke ndjekur lëndët e përcaktuar për të shlyer kreditet që nuk i janë njohur.

#### **D) Për transferim të studimeve në ciklin e dytë të studimeve**

1. Transferimi bëhet në fillim të vitit akademik dhe nga kandidatë që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë që përputhet me kërkesat sic përcaktohen në kriteret e miratuara (sipas pikës A) për pranimet në ciklin e dytë për të cilën po aplikon kandidati.
2. Për programin e studimit në fushën e mësuesisë që ofron FSHL, pranohen të aplikojnë vetëm ata kandidatë që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve bachelor në FSHL ose të njëjtë me të.
3. Fakultetet, në rastin e miratimit të transferimit të studimeve, bëjnë njohje të krediteve dhe mund të përcaktojnë shlyerje të krediteve të caktuara bazuar në nenin 89, Ligji 80/2015, aktet nënligjore e aktet e brendshme.
4. Bazuar në njohjen e krediteve të fituara nga studenti në IAL nga vjen dhe mbështetur në njësimin me Planin Mësimor të programit të studimit të UST në të cilin studenti kërkon të transferojë studimet, nëse për studentin përcaktohen më shumë se 30 kredite për shlyerje, atëhere ai nuk mund të regjistrohet në një kurs më të lartë se ai që ka përfunduar, por vazhdon studimet në të njëjtin kurs duke ndjekur lëndët e përcaktuar për të shlyer kreditet që nuk i janë

#### **E) Për ndjekjen e një programi të dytë studimi, cikli i parë i studimit.**

1. Fakultetet organizojnë konkursin nëpërmjet testeve praktike, për studentët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë, por që nuk i janë nënshtruar ndonjë konkursi praktik, ose konkursi praktik që mund të kenë kryer nuk është i njëjtë ose i përfërt me ato që organizon fakulteti.
2. Fakultetet mund të bëjnë njohje të krediteve të lëndëve të programit të studimit që kanë kryer studentët bazuar aktet nënligjore e aktet e brendshme.
3. Kandidatët që aplikojnë për një program të dytë studimi në ciklin e parë duhet të plotësojnë notën mesatare të shkollës së mesme sipas VKM në fuqi.

#### **F) Për ndjekjen e një programi të dytë studimi, cikli i dytë i studimit**

1. Ndjekja e një programi të dytë studimi në ciklin e dytë, bëhet nga kandidatë që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë që përputhet me kërkesat sic përcaktohen në kriteret e miratuara (sipas pikës A) për pranimet në ciklin e dytë për të cilën po aplikon kandidati.

2. Për programin e studimit në fushën e mësuesisë që ofron FSHL, pranohen të aplikojnë vetëm ata kandidatë që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve bachelor në FSHL ose të njëjtë me të.
3. Fakultetet mund të bëjnë njohje të krediteve të lëndëve të programit të studimit që kanë kryer studentët bazuar aktet nënligjore e aktet e brendshme.

H) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Rektorati, Dekanët e Fakulteteve, Dega e Informacionit Studentor dhe Rregjistrimeve.

G) Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë..

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Agron ÇUKA**

